

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR "IG SOLE LUNA " SH.P.K.**

Sot me date 17/01/2017 me cilesine e ortakeve themelues si me poshte :

1- **Z. Imirjan Gropa** , shtetas shqiptar , I biri I Mane, lindur me dt. 09.11.1972 ne Fier dhe banues ne Patos, Fier, madhor , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar , identifikuar me karten e identitetit shqiptare me nr.personal : H21109047F

1- **Z. Asllan Veliaj** , shtetas shqiptar , i biri i Hazis-it , lindur me dt. 03.01.1968 ne Lofkend dhe banues ne Lagjen 1-Maj Fier , madhor , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar , identifikuar me karten e identitetit shqiptare me nr.personal : G80103077W.

Bazuar ne Ligjin Nr. 9901 , dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" , Ligjin Nr. 9723 Dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" , sot me dt. 17/01/2017 , hartojme kete Akt-Themelimi te shoqerise tregetare si me poshte vijon :

Me neneshkrimin e ketij Akt - Themelimi te shoqerise tregtare , ne nenshkruesit dhe themeluesit e saj marrim persiper te realizojme e te respektojme te drejtat dhe detyrimet me precizimet e meposhtme :

NENI 1

Te formojme Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar qe mban emrin "**IG Sole Luna**"SH.P.K.

NENI 2

Shoqeria Tregtare "**IG Sole Luna**"SH.P.K. , ka formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.

NENI 3

3.1. Shoqeria e ka seline e saj qendrore ne Sarande-Borsh Ndertes 1-kateshe Nr 1, Nr Pasurie 90/3, Zona kadastrale 1253 volum12 faqe79.

3.2. Ndryshimi i selise qendrore te shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise.

NENI 4

Kohezgjatja e shoqerise parashikohet te jete mbi 10 vjet ,por ky afat mund te nderpritet apo te zgjatet me tej ,gjithmone ne funksion te kompetencave te ortakeve themelues te shoqerise .

NENI 5

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ,por ai mund te ushtrohet dhe jashte ketij territori ,me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregetar.

NENI 6

Themeluesit e Shoqerise "IG Sole Luna"SH.P.K.me kete akt- themelimi , marrin persiper qe te respektojne te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar per shoqerite tregtare me pergjithesi te kufizuar , si dhe ti permbahet kriterit te respektimit te politikes tregtare qe zhvillohet sot ne Republiken e Shqiperise.

NENI 7

7.1. Kapitali themeltar i Shoqerise "IG Sole Luna"SH.P.K.ne momentin fillestar te krijimit eshte 100,000.00 (Njeqind mije)leke, i cili do te regjistrohet ne llogarine e shoqerise prane nje banke shqiptare te nivelit te dyte , i gjithi i nenshkruar dhe i shlyer prej ortakeve .

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te saj , kapitali Themeltar i kesaj shoqerie mund te zmadhohet .

7.2. Ortaket kane kontribuar dhe zoterojne ne kapitalin e shoqerise kuotat si me poshte :

1- **Z.Imirjan Gropa**, eshte zoterues i nje kuote prej **50 % te kapitalit themelues** te shoqerise ose i shprehur ne vleren e kapitalit themeltar 50,000.00 leke(pesedhete mije leke vetem).

2- **Z. Asllan Veliaj** , eshte zoterues i nje kuote prej **50 % te kapitalit themelues** te shoqerise ose i shprehur ne vleren e kapitalit themeltar 50,000.00 leke(pesedhete mije leke vetem).

NENI 8

Shoqeria "IG Sole Luna"SH.P.K. ashtu sikurse eshte parashikuar ne Aktin Themelues te Shoqerise , aktiviteti i saj kryesor i veprimtarise do te kete :

"Sherbim hotelerie- Bar Restorant Eksport-Import te materialeve te ndryshme.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve .

2 – Administratori.

Detyrat e organeve drejtuese te shoqerise do te percaktohen ne Statutin e shoqerise.

NENI 10

Ortaket e vetem themelues te shoqerise kane vendosur qe si **administrator** i Shoqerise"IG Sole Luna"SH.P.K.do te jete **Z.Imirjan Gropa** .

Ajo pergjigjet mbi bazen e kompetencave te tij te percaktuara ne Statutin e shoqerise . Gjithashtu ai merr persiper se do konfirmoje emrat e ortakeve qe mund te shtohen ,pjeset e kapitalit themeltar si dhe shumen e derdhur nga secili prej tyre.

Gjithashtu ai pergjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise , te cdo natyre qofshin ,te shlyeje detyrimet qe ka Shoqeria me te tretat Brenda vleres se kapitalit ,te beje mbi bazen e kontributeve te dhena shperndarjen e fitimit.

Si organ ekzekutiv i Shoqerise ,te drejtit dhe detyrat e administratorit ,rregullohen me aktet themeluese te Shoqerise ,Statutin e Shoqerise si dhe aktet e tjera normative te nxjerra nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve apo dhe me marreveshje te vecanta.

NENI 11

Mandati i Administratorit , per administrimin ne kete shoqeri ,eshte **per nje periudhe 5 vjet me te drejte ripertesitje .**

Administratori apo ai qe i delegohet ky pushtet ,ka te gjitha kompetencat te cilat ai deklarohet se i njej dhe i pranon ,per te kryer te gjitha detyrimet qe i linden ne baze te statutit te Shoqerise , sikurse parashikohet ne legjislacionin e Shtetit shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Tre Ligjet per Shoqerite Tregtare ".

NENI 12

Ortaket ,administratori dhe punonjesit e shoqerise "IG Sole Luna" SH.P.K.pergjigjen ndaj shoqerise per demin e shkaktuar nga perhapja e sekreteve tregtare , per te cilat kane dijeni , per shkak te kryerjes se funksioneve te tyre ne shoqeri.

NENI 13

Te gjitha mosmarreveshjet midis ortakeve duhet te zgjidhen me mirekuptim . Ne rastet kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim secili prej ortakeve ka te drejte ti drejtohet per zgjidhje Gjykates kompetente.

NENI 14

Ortaket themelues **te shoqerise** deklarojne se i njohin te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt – themelues i Shoqerise "IG Sole Luna"SH.P.K.dhe me vullnet te lire e firmosin ate.

Ky Akt-Themelimi perpilohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe , te gjitha me te njejten vlere ligjore.

PER SHOQERINE "IG Sole Luna" SH.P.K.
ORTAKET THEMELUES

1) - Z.Imirjan Gropa

Imirjan Gropa

2) - Z. Asllan Veliaj

Asllan Veliaj